



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Drenasit
Zyra e Kryetarit



01- Nr- 020/04-13832 dt. 20/04/2023

Në vështim të nenit 13 dhe 58, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 72 të Statutit të Komunës së Drenasit, nenit 22 të Ligjit Nr. 06/L-092, për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 27 të Rregullores (QRK) Nr.06/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 49, të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kryetari i Komunës, nxjerr këtë:

V E N D I M

Për formimin e Komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës gjatë vitit 2020

- I. Anëtarët e Komisionit për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës gjatë vitit 2020, janë:
 1. Bujar Plakiqi (kryetar),
 2. Fadil Tahiri (anëtar),
 3. Florie Krasniqi (anëtare).
- II. Komisioni për mbikëqyrjen e realizimit të kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës gjatë vitit 2020, bën mbikëqyrjen dhe raporton në përputhje me kontratat e nënshkruara për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim, Komisioni i cili ka mandat 4 vjeçar.
- III. Ky komision, ka për detyrë që pas dhënies së rekomandimit fillestar, të bëjë raport çdo 6 muaj për ecurinë e zbatimit të planit dinamik, si dhe përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata, duke i rekomanduar Kryetarit të Komunës marrjen e masave përkatëse në rast të mos përmbushjes së kontratave.
- IV. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi nr.01-020/04-64878, i datës 19.12.2022.
- V. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.



Kryetari i Komunës
Ramiz Lladrovci

Iu dërgohet:

- Zyrës së Kryetarit;
- Anëtarëve të Komisionit;
- Arkivit të Komunës së Drenasit.